

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk, Kryetar i trupit gjykues dhe Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Gjyqtarja Fllanza Kadiu dhe Fillim Skoro, si anëtarë të kolegjit, me zyrtarin ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, duke vepruar në cilësinë e procesmbajtësit,

Në rastin penal kundër:

1. **K.P.**, emri i babait Z., emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës M. M., i lindur më ... në fshatin XXX, Komuna e Y, me banim në XXX, Kosovë, shqiptar nga Kosova, i martuar, baba i tre fëmijëve, \_\_\_ me profesion, i gjendjes mesatare financiare,  
Në paraburgim në një rast tjetër që nga 24 maji i vitit 2012, momentalisht është duke e vuajtur një dënim me burgim në një rast tjetër penal;
2. **Z.M.**, emri i babait N., i lindur më ... në Y, me banim në XXX, Kosovë, shqiptar nga Kosova;
3. **L.M.**, emri i babait P., emri i nënës V., i lindur më ... në G., Kosovë, momentalisht me banim në rrugën XXX, Kosovë, shqiptar nga Kosova, me profesion \_\_\_, i gjendjes mesatare financiare;

Me anë të Aktakuzës PPS 22/2009, të ngritur më 5 korrik të vitit 2011 dhe të konfirmuar më 11 shtator të vitit 2011, të ngarkuar për kryerjen e veprave penale si në vijim:

1. **K.P.:**
  - a) (Pika një) **Krimi i organizuar** në shkelje të nenit 274 (1) të<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejme KPK), në lidhje me nenin 339 (1) dhe (3) të KPK-së;
  - b) (Pika dy) **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore**, në kundërshtim me nenin 346 të KPK-së;
  - c) (Pika tre) **Falsifikimi i dokumenteve si raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve**, në shkelje të neneve 332 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 333, nën-paragrafi 1 të KPK-së, e kufizuar me autorizimin gjoja të dhënë nga palët e dëmtuara G., R. F., L. G. dhe J. N.;
  - d) (Pika katër) **Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit**, në shkelje të nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 dhe 25 të KPK-së;
  - e) (Pika gjashtë) **Pastrimi i parave** në kundërshtim me Nenin 10 (2) a) dhe b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2;
  - f) (Pika tetë) **Pastrimi i parave** në bashkëkryerje me L.M., në shkelje të nenit 10 (2) a) dhe b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2;

---

<sup>1</sup> I hedhur në qarkullim si "Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ", i shpallur si Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, të datës 6 korrik 2003, i riemëruar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03 / L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

- g) (Pika nëntë) **Shmangia nga tatimi**, në shkelje të nenit 249 (1) dhe (2) të KPK-së;
- h) (Pika njëmbëdhjetë) **Mashtrimi**, në shkelje të nenit 261 (2) të KPK-së;

**2. Z.M.:**

- a) (Pika një) Krimi i organizuar në shkelje të nenit 274 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 339 (1) dhe (3) të KPK-së;
- b) (Pika dy) **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore**, në kundërshtim me nenin 346 të KPK-së në lidhje me nenin 23 të KPK-së;
- c) (Pika katër) **Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit**, në shkelje të nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 25 të KPK-së;
- d) (Pika shtatë) **Pastrimi i parave**, neni 10 (2) a) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2;
- e) (Pika njëmbëdhjetë) **Mashtrimi** në shkelje të nenit 261 (2) të KPK-së;

**3. L.M.:**

- a) (Pika dy) **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore**, në shkelje të nenit 346 dhe 25 të KPK-së;
- b) (Pika tetë) **Pastrimi i parave**, në kundërshtim me Nenin 10 (2) a) dhe b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2;
- c) (Pika dhjetë) **Shmangia nga tatimi**, në shkelje të nenit 249 91) dhe (2) të KPK-së;
- d) (Pika njëmbëdhjetë) **Mashtrimi**, në shkelje të nenit 261 (2) të KPK-së.

Me aktgjykim të shkallës së parë P. nr 13/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 19 tetor të vitit 2012, i pandehuri **K.P.** ishte shpallur **I pafajshëm** për veprat penale të:

**Krimit të Organizuar** (Pika një) në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1, i lexuar në lidhje me nenin 339, paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së,

**Falsifikimi i dokumenteve si raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve** (Pika tre e pjesshme) në shkelje të neneve 332 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 333, nën-paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me palën e dëmtuar J. N.,

**Pastrimit të Parave** (Pika tetë) në bashkëkryerje me L.M., në kundërshtim me nenin 10 (2) a) dhe b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 dhe

**Shmangia nga tatimi** (Pika nëntë), në kundërshtim me nenin 249 (1) dhe (2) të KPK-së;

Akuza për **Falsifikimi i dokumenteve si raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve** (Pika tre e pjesshme) në shkelje të neneve 332 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 333, nën-paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me të gjitha palëve të dëmtuara, përveç J. N., ishte refuzuar, pasi që prokuroria e tërhoqi akuzën;

I pandehuri K.P. ishte shpallur **Fajtor** për veprat penale të:

**Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore** (Pika dy) në kundërshtim me nenin 346 të KPK-së,

**Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit** (Pika katër) në shkelje të nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 dhe 25 të KPK-së,

**Pastrimi i parave** (Pika gjashtë) në kundërshtim me nenin 10 (2) a) dhe b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 dhe

**Mashtrimi** (Pika njëmbëdhjetë) në shkelje të nenit 261 (2) të KPK-së;

I pandehuri u dënua me një dënim të përgjithshëm prej dhjetë (10) vitesh burgim dhe me dënimin plotësues të ndalimit nga ushtrimi i funksioneve në shërbimet publike apo në administratën publike dhe nga ushtrimi i profesionit të avokatit për një periudhë prej tri (3) vitesh;

Të pandehurit **Z.M.** dhe **L.M.** u liruan nga të gjitha akuzat;

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga Prokurori Special më 28 dhjetor të vitit 2012, Ankesën e parashtruar nga ana e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit K.P. në të njëjtën datë dhe Ankesën e paraqitur nga i pandehuri K.P. më 4 janar të vitit 2013 kundër Aktgjykimit P. Nr 13/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 19 tetor të vitit 2012, ndërsa gjithashtu duke marrë parasysh përgjigjen e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit K.P. ndaj ankesës së Prokurorit Special, të paraqitur më 4 shkurt të vitit 2013 dhe të propozimit të Prokurorit të Apelit të parashtruar më 12 qershor 2013,

Pasi mbajtjes së një seance publike më 10 qershor 2015, nxjerr këtë:

## **AKTGJYKIM**

- 1. Me rastin e ankesave të ushtruara kundër Aktgjykimit P. nr. 13/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 19 tetor të vitit 2012, Aktgjykimi i kontestuar NDRYSHOHET EX OFFICIO siç vijon: AKUZA KUNDËR TË PANDEHURIT K.P. për veprën penale të mashtrimit, në shkelje të nenit 261 paragrafi 2 të KPK-së HIDHET POSHTË.**
- 2. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit K.P. më 28 dhjetor të vitit 2012 dhe Ankesa e ushtruar nga i pandehuri K.P. më 4 janar të vitit 2013 kundër Aktgjykimit të lartpërmendur PRANOHEN SI TË BAZUARA MIRË. PJESA e Aktgjykimit, QË E SHPALL FAJTOR TË PANDEHURIN K.P. DHE PJESA E DËNIMIT, SHFUQIZOHEN.**
- 3. PRANOHET PJESËRISHT ankesa e ushtruar nga Prokurori Special më 28 dhjetor të vitit 2012 kundër Aktgjykimit të lartcekur. ANULOHEN PJESËT e**

**Aktgjykimit të kontestuar LIDHUR ME LIRIMIN E TË PANDEHURIT K.P..  
PJESA E MBETUR e Ankesës REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

- 4. Rasti kundër K.P. KTHEHET PËR RIGJYKIM DHE VENDIM.**
- 5. VËRTETOHEN PJESËT e Aktgjykimit QË LIDHEN ME PAFAJËSINË E të pandehurve L.M. DHE Z.M..**

**ARSYETIMI**

**I. Historiku procedural**

Rasti ka të bëjë me një mori të rasteve të dyshuara të veçanta të Mashtrimit, Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit dhe Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore që kanë ndodhur nga dhjetori i vitit 2004 deri në dhjetor të vitit 2007.

I pandehuri K.P. ishte gjyqtar i Gjykatës Komunale të Y nga 1 janari i vitit 2000 deri më 1 shtator të vitit 2009. Z.M. ka punuar si avokat në Y nga 16 shtatori i vitit 2000 deri më 5 korrik të vitit 2011. Para asaj kohe, nga 1 janari i vitit 1978 deri më 24 mars të vitit 1999, ai ishte gjyqtar në Gjykatën Komunale të Y. L.M. ishte një praktikant ligjor në Gjykatën Komunale në Y. Pasi u pranua zyrtarisht në avokati, nga 16 shtatori i vitit 2007 deri më 5 korrik të vitit 2011 ai ka punuar si avokat në Y.

Më 5 korrik 2011 u ngrit Aktakuza PPS 22/2009, që i akuzonte tre të pandehurit me veprat penale të përshkruara më lart.

Më 11 shtator 2011 u konfirmua Aktakuza.

Më 22 maj 2012, filloi shqyrtimi gjyqësor para një kolegji të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, që përbëhej nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor. Më 19 tetor 2012, Gjykata nxori Aktgjykimin P. nr. 13/2012, duke e shpallur të pandehurin K.P. fajtor për kryerjen në dy raste të veprës penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, një akuzë për Keqpërdorim të pozitës zyrtare apo të autorizimit, dy raste të Pastrimit të parave dhe një akuzë për Mashtrim. Ai u lirua nga akuzat e tjera. I pandehuri u dënua me një dënim të përgjithshëm prej dhjetë (10) vitesh burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik dhe nga ushtrimi i profesionit të avokatit për një periudhë prej tri (3) vitesh.

Të pandehurit Z.M. dhe L.M. u liruan nga të gjitha akuzat.

Më 28 dhjetor të vitit 2012, Prokurori Special ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur.

Në të njëjtën ditë avokati mbrojtës Tahir Rrecaj ushtroi ankesë në emër të të pandehurit K.P..

Më 4 janar të vitit 2013, vetë i pandehuri K.P. ushtroi ankesë.

Më 4 shkurt të vitit 2013, avokati mbrojtës Ramë Gashi, në emër të të pandehurit L.M., ushtroi përgjigje ndaj ankesës së Prokurorit Special.

Më 12 qershor 2013, Prokurori i Apelit parashtroi Propozimin e tij lidhur me ankesat.

## **II. Parashtrësit e palëve**

### **1. Ankesa e ushtruar nga Prokurori Special**

Prokurori Special në ankesën e tij e konteston Aktgjykimin mbi bazën e shkeljeve thelbësore të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe dështimit për të shpallur vendimin shtesë - gjobën.

Ai e konteston Aktgjykimin në të gjitha pikat që kanë të bëjnë me lirimin e të akuzuarit K.P., Z.M. dhe L.M., sepse gjatë hetimeve dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është konstatuar padyshim se të tre të pandehurit kanë kryer veprat penale, për të cilat ata kishin qenë të akuzuar. Ai i referohet arsytimit të Aktakuzës dhe fjalës së tij përfundimtare, kur ai deklaroi se aktivitetet kriminale përbënin veprën penale të Krimin të organizuar, në formën e një grupi të organizuar dhe të strukturuar, i cili ishte krijuar, organizuar, strukturuar dhe drejtuar nga K.P.. Në të njëjtën kohë ai ishte duke ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Komunale të Y dhe funksionin e avokatit privat duke përfaqësuar palët e dëmtuara, edhe pse licenca e tij kishte skaduar, ai u emërua si gjyqtar komunal.

Në lidhje me të pandehurin Z.M., Prokurori pohon se gjykata e shkallës së parë ka vepruar gabimisht, pasi që është vërtetuar në mënyrë të qartë gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor, që ai kishte kryer veprat penale, për të cilat është akuzuar.

Sa i përket të pandehurit L.M., gjykata ka gabuar, pasi që i akuzuari L.M. e ka ndihmuar në mënyrë të konsiderueshme të akuzuarin K.P. në kryerjen e veprave penale, për të cilat ai është akuzuar. Ai më tej thekson se L.M. në kohën kur ai e kishte ndihmuar K.P. në blerjen e banesës në Prishtinë, ai ishte një avokat privat dhe konsiderohet të ketë një njohuri solide të të gjitha procedurave ligjore, që kanë të bëjnë me shitjen e pasurisë së paluajtshme. Prokurori pohon se gjykata ka gabuar në të gjitha rastet kur e liroi të akuzuarin nga përgjegjësia penale. Ai pohon se gjykata është dashur të shpallë një dënim shtesë në formën e një gjobe për të pandehurin K.P., në përputhje me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2.

Prokurori i propozon gjykatës së shkallës së dytë për të ndryshuar pjesën shfajësuese të Aktgjykimit, në mënyrë që i akuzuari K.P., Z.M. dhe L.M. të shpallen fajtorë për veprat penale, prej të cilave ata u liruan dhe rrjedhimisht të dënohen me dënimin në përputhje me ligjin ose të shfuqizojë vendimin e kundërshtuar në pjesën shfajësuese dhe ta kthejë çështjen për rigjykim.

## **2. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të K.P.**

Avokati mbrojtës në ankesën e tij në emër të të pandehurit K.P. e konteston Aktgjykimin e kundërshtuar, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës penale, në pajtim me nenin 403 paragrafi 1 pikat 10, 12 dhe paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës<sup>2</sup> (në tekstin e mëtejme: KPPK-së ), shkelje të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionet penale.

Ai thekson se aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm, në brendësi kontradiktor dhe në kundërshtim me bazat për Aktgjykimin.

Në lidhje me veprën penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, Aktgjykimi është në kundërshtim me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor. Përshkrimi faktik është tërësisht në kundërshtim me gjetjet. Nuk u vërtetua me asnjë dëshmi materiale se Aktgjykimi në fjalë ishte lëshuar nga K.P., sepse përndryshe Aktgjykimi do të ishte regjistruar në shkrimoren e gjykatës. Vepra e Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore mund të kryhet vetëm nga gjyqtari, ndërsa kryen një detyrës zyrtare, si gjyqtar në procedura që kryhen në kuadër të detyrave dhe kompetencave të tija ligjore. Në rastin gjyqësor C. Nr. 54/2000, në të cilën u arrit marrëveshja në gjykatë në shumën prej 56,000 euro, ai as nuk e plotësoi shabllonin me emrin e L.M. dhe as nuk e nënshkroi apo vulosi atë. Për shkak të mungesës së një analize të ekspertëve të grafologjisë, gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se ai kishte kryer veprime të tilla. Në këtë rast, avokati L.M. i përfaqësoi paditësit me autorizim nga pala dhe nuk ishte caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në lidhje me shumën prej 53.000 euro që pretendohet se i pandehuri K.P. i kishte marrë nga L.M., gjykata ishte e njëanshme, sepse ajo ia ka dhënë besimin e plotë L.M.. Konstatimi i gjykatës është i bazuar tërësisht në deklaratën e L.M. dhe jo i vërtetuar nga ndonjë dëshmi tjetër.

Në lidhje me veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit, dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë. Përshkrimi faktik është në kundërshtim të plotë me cilësimin juridik të veprave penale. Ndërsa vepra penale është kualifikuar si bashkë-kryerje (neni 23 të KPK-së) dhe ndihmë (neni 25 të KPK-së), nga përshkrimi faktik nuk duket se K.P. e ka kryer këtë vepër penale në bashkëpunim me dikë tjetër apo i ndihmuar nga dikush tjetër.

Gjykata e shkallës së parë e ka tejkualuar aktakuzën, pasi që K.P. nuk ishte akuzuar për veprën penale të Mashtrimit dhe as prokurori publik nuk e zgjeroi Aktakuzën gjatë seancave gjyqësore në lidhje me veprën penale të Mashtrimit. Duke tejkualuar aktakuzën, gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 386 paragrafi 1 të KPPK-së.

Shkelja tjetër është Neni 33 i KPPK-së në lidhje me procedurën e përbashkët penale. Ndarja e çështjes në disa procedura penale paraqet shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 403 paragrafi 2 pika 1) dhe 2) të KPPK-së. Zbatimi i procedurës së përbashkët për të gjitha

---

<sup>2</sup> Hedhur në qarkullim si 'Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës ', i shpallur si Rregullore e UNMIK-ut 2003/26, të datës 6 korrik 2003, e riemëruar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03 / L-003, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

rastet do të ishte plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore, për shkak se në të katër rastet kundër tij, Kompania e Sigurimeve "Kosova" në likuidim është paraqitur si palë.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka vlerësuar provat dhe faktet në lidhje me veprën penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, sipas nenit 346 të KPK-së. Kjo vepër penale kërkon qëllimin e drejtpërdrejtë të kryesit për të fituar një dobi pasurore të kundërligjshme për atë apo për personat tjerë ose t'i shkaktojë dëm personit tjetër. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar për të vërtetuar ekzistencën e këtij qëllimi. Nga provat e administruara rezulton se i pandehuri, në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Y ishte caktuar për rastin C.nr. 54/2000 nga kryetari i gjykatës dhe se ai e kishte marrë rastin përsipër si çdo rast tjetër. Për këtë arsye, gjykata ka shkelur nenin 404 të KPPK-së.

Në lidhje me Aktgjykimin C.nr. 282/2005, Ankesa pretendon se vendimi i tillë nuk ka ekzistuar kurrë dhe as nuk është regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Komunale në Y. I pandehuri pretendon se ka dëgjuar për këtë rast për herë të parë përmes aktakuzës në rastin e tanishëm. Ky aktgjykim kurrë nuk iu kishte nënshtruar ekspertizës së një eksperti të grafologjisë.

Në lidhje me veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit, i pandehuri pretendon se, në mënyrë që të kryhet kjo vepër penale, është i nevojshëm qëllimi i drejtpërdrejtë. Gjykata ka dështuar që të vërtetojë qëllimin dhe nuk ka vërtetuar se nënshkrimi dhe vula janë vënë në dokument nga i pandehuri K.P. dhe as nuk dhe as nuk ka vërtetuar shpërdorimin e vulës nga i pandehuri. Me kusht që autorizimet ishin përdorur nga i ndjeri H.H., gjykata duhet t'i kishte dhënë besim deklaratës së K.P. se ky i fundit ishte përgjegjës për falsifikimet.

Gjykata asnjëherë nuk konstatoi se kishte ndodhur ndonjë falsifikim i mundshëm brenda pozitës zyrtare të të pandehurit ose autoritetit si gjyqtar i Gjykatës Komunale. Gjykata është dashur që t'i ketë ri-cilësuar akuzat në fjalë si Mashtrim.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht se K.P. ka pranuar se ka marrë pjesë në Mashtrimet e kryera kundër kompanisë së sigurimeve "Kosova".

Në lidhje me veprën penale të Pastrimit të parave, gjykata gabimisht ka konstatuar se i pandehuri K.P. i dha L.M. 65,000 euro për blerjen e një banese nga A. J.. Dëshmia e dëshmitarit T. P. vërtetoi se paratë në fjalë ishte të T. P. e jo të të pandehurit.

Gjithashtu konstatimi i gjykatës se i pandehuri K.P. i kishte blerë pronat e përmendura në pikën gjashtë (6) të Aktakuzës me qëllimin për të fshehur origjinën e të ardhurave të veprave penale, është i pabazuar, pasi që pronat ishin blerë ose para kohës që përfshin Aktakuza apo nga anëtarët e familjes së të pandehurit me paratë e tyre dhe me të vetmin qëllim, për të përmirësuar mirëqenien e familjes së të pandehurit.

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar provat gabimisht. Gjykata nuk e pranoi faktin se i pandehuri K.P. mund të ketë qenë mashtruar nga H.H..

Gjykata është dashur të ketë marrë parasysh nenin 60 paragrafi 2 të KPK-së në lidhje me konfiskimin. Shtëpia në Klinë, e cila ishte konfiskuar përkohësisht (faqja njëmbëdhjetë [11] e Aktgjykimit) është në pronësi të vëllait të të pandehurit, T. P. dhe nuk mund të jetë subjekt i konfiskimit, pasi që nuk ishte vërtetuar se ajo ishte rezultat nga kryerja e një veprë penale.

Në faqen dymbëdhjetë (12) të Aktgjykimit të kontestuar gjykata gabimisht ka konstatuar se njëسيا e biznesit në Klinë u ble në vitin 2005. Atë vit ishte vërtetuar vetëm kontrata e shitjes, e lidhur më herët në vitin 1997, pasi që para konfliktit në Kosovë, një ligj e ndalonte bartjen e pasurive të patundshme në mes të personave të kombësive të ndryshme.

Sa i përket sanksioneve penale, ai parashtron se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ajo i ka mbitheksuar rrethanat rënduese dhe nuk i ka marrë parasysh mjaftueshëm të gjitha ato lehtësuese. Gjykata është dashur të ketë pasur parasysh si rrethana lehtësuese atë, që i pandehuri kërkoi falje dhe ishte bashkëpunues me gjykatën.

Gjykata gabimisht e ka konsideruar lartësinë e dëmit si rrethanë rënduese. Një shumë e lartë e dëmit është një formë e kualifikuar nga veprat penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare të autorizimit (neni 339 paragrafi 2 të KPK-së) dhe Mashtrimit (neni 261 paragrafi 2 të KPK-së), dhe nuk mund të konsiderohet përsëri si rrethanë rënduese.

Në dënimin plotësues gjykata nuk është dashur që ta shqiptonte ndalimin për ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, por është dashur që ta kufizonte kufizimin në mënyrë specifike për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit.

Ai propozon që të aprovojë ankesën si të bazuar dhe, në përputhje me nenin 426 të KPPK-së, për të ndryshuar Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lirojë të pandehurin nga të gjitha akuzat ose, përndryshe, në pajtim me nenin 424 paragrafi 1 të KPPK-së, që të anulojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthejë çështje në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

### **3. Ankesa e ushtruar nga i pandehuri K.P.**

I pandehuri në ankesën e tij pretendon shkelje thelbësore nga neni 403 i KPPK-së, duke deklaruar se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në përmbajtjen e saj dhe në arsyetimin e saj. Aktgjykimi nuk jep arsye lidhur me faktet vendimtare, ndërsa arsyetimi i paraqitur është plotësisht i paqartë dhe kontradiktor.

Në një shkallë të madhe Ankesa përsërit argumentet e paraqitura në Ankesën e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit.

Në lidhje me veprën penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, arsyetimi është i paqartë dhe kontradiktor në vetvete. Përshkrimi faktik është në kundërshtim të plotë me gjetjet. Nuk u vërtetua se K.P. e kishte lëshuar Aktgjykimin në fjalë.



Dispozitivi në lidhje me veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit, është i paqartë. Përshkrimi faktik është në kundërshtim të plotë me cilësimin juridik të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 403, paragrafi 12 dhe nenit 396 paragrafët 6 dhe 7 të KPPK-së, duke mos vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse.

Gjykata e shkallës së parë e ka tejkalluar Aktakuzën duke e gjetur të pandehurin K.P. fajtor për veprën penale të Mashtrimit. Në këtë mënyrë, gjykata ka shkelur nenin 403 paragrafi 1 pika 10 e KPPK-së.

Vlerësimi i gjykatës në lidhje me veprën penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, nuk është i saktë. Gjykata ka vlerësuar gabimisht provat dhe faktet dhe si pasojë, është zbatuar gabimisht Neni 346 i KPK-së. Gjykata nuk e ka vërtetuar qëllimin si element thelbësor i kësaj vepre penale. I pandehuri K.P. nuk është në dijeni lidhur me Aktgjykimin C. Nr. 282/2005, dhe as për faktin që ai të ketë marrë pjesë në një procedurë gjyqësore në lidhje me këtë rast. Lidhur me rastin C. Nr. 54/2000, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar gabimisht se K.P. ka lëshuar këtë vendim në mënyrë të paligjshme.

Në lidhje me veprën penale për Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit, avokati mbrojtës thotë se, në mënyrë që kjo vepër penale të ekzistojë, duhet gjithashtu të vërtetohet qëllimi, pasi që ky akt duhet të ndërmerret në kuadër të pozitës apo autoritetit zyrtar. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar gabimisht se i pandehuri K.P. ka falsifikuar një autorizim në kuadër të të drejtave të tij si një autoritet si gjyqtar.

Për sa i përket konfiskimit, Avokati mbrojtës thekson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se pronat e përmendura në pikën gjashtë të Aktakuzës janë krijuar nga vepra penale e pastrimit të parave.

Sa i përket sanksioneve penale, ai parashtron se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ajo i ka mbitheksuar rrethanat rënduese dhe nuk i ka marrë parasysh mjaftueshëm të gjitha ato lehtësuese.

Ai është dashur t'i ketë besuar bashkëpunimit të të pandehurit me gjykatën si dhe faktin se ai ka qenë i dënuar me pesë (5) vjet burgim për të njëjtën vepër penale dhe janë edhe dy raste të ngjashme që po zhvillohen kundër tij.

Ai i propozon gjykatës së shkallës së dytë që të aprovojë Ankesën dhe të ndryshojë Aktgjykimin e goditur dhe ta lirojë atë nga të gjitha akuzat.

#### **4. Përgjigja e avokatit mbrojtës Ramë Gashi në emër të të pandehurit L.M. ndaj Ankesës së Prokurorit Special**

Avokati mbrojtës parashtron se gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata ka vërtetuar në mënyrë korrekte gjendjen faktike, siç pasqyrohet në mënyrë korrekte në Aktgjykimin e kundërshtuar. Nuk ka rrethana që fajësojnë të pandehurin L.M.. Ai nuk ka kryer ndonjë vepër penale dhe as nuk e ka ndihmuar të akuzuarin K.P. në ndonjë vepër penale. L.M.

është mashtruar nga të tjerët dhe nuk është në dijeni për ndonjë veprë penale. Ai nuk kishte të bënte asgjë me falsifikimin e autorizimeve për përfaqësimin e palëve të dëmtuara; që është bërë nga i akuzuari K.P.. Ai gjithashtu i zgjidhte rastet dhe i mbante për vete të gjitha paratë e paguara si kompensim. L.M. nuk ishte palë në transaksionin e blerjes së banesës. K.P. ishte blerësi; ai e pagoi çmimin e blerjes dhe i përpiloi të gjitha dokumentet e nevojshme, ndërsa L.M. nuk ishte në dijeni për ndonjë veprë penale.

Avokati mbrojtës propozon që të refuzojë Ankesën e prokurorisë PPS. Nr. 22/2009, të datës 28 dhjetor 2012, si të pabazuar dhe të thërrasë të pandehurin L.M. dhe avokatin mbrojtës Ramë Gashi për seancën e Gjykatës së Apelit.

## **5. Mocioni i Prokurorit të Apelit**

Prokurori i Apelit pohon se ankesa e Prokurorit Special është e bazuar mirë, ndërsa Ankesa e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj dhe Përgjigjja e avokatit Ramë Gashi ndaj Ankesës së prokurorisë janë të pabaza.

Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor përmbajnë fakte të padiskutueshme, që fajësojnë të pandehurin K.P. për kryerjen e veprës penale të Krimit të organizuar. Gjithashtu i pandehuri Z.M. ka marrë pjesë në aktivitetet kriminale të grupit të organizuar, duke ia mundësuar K.P. që ta shfrytëzojë llogarinë e tij bankare. Dokumentet e gjetura në zyrën e tij dëshmojnë se ai kishte tërhequr para nga llogaria dhe ai ishte i në dijeni se K.P. ka pasur autorizimin për të përdorur llogarinë e tij.

L.M. kishte ndihmuar K.P. në veprën e Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore. Pagesat për të pandehurin K.P. ishin transferuar në llogarinë e tij dhe ai ishte i përfshirë në blerjen e një banesë për K.P..

K.P. gjithashtu kishte lidhje të ngushta me të ndjerin H.H., i cili ishte Shef i Komisionit për dhënien e kompensimit të dëmit. I pandehuri ia dha H.H. një zarf, në të cilin gjendeshin të holla.

Gjykata e shkallës së parë duhet të kishte shqiptuar edhe dënim plotësues të gjobës.

Mocioni propozon (1) të miratojë si të bazuar mirë Ankesën e Prokurorit Special dhe të ndryshojë Aktgjykimin e kontestuar lidhur me pjesën e pafajësisë, duke i shpallur të pandehurit K.P., Z.M. dhe L.M. fajtorë si dhe t'i dënojë ata siç parashihet me ligj ose, përndryshe, të anulojë pjesën e Aktgjykimit lidhur me pafajësinë dhe të kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje; dhe

(2.) të refuzojë Ankesën e parashtruar nga avokati mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit K.P. dhe Përgjigjen e Prokurorisë së Apelit të parashtruar në emër të të pandehurit L.M..

### III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

#### 1. Pranueshmëria e ankesave

Gjykata e Apelit konstaton se Ankesa e parashtruar nga prokuroria dhe ankesat e parashtruara në emër të të pandehurit K.P. dhe nga vetë i pandehuri K.P. janë parashtruar me kohë dhe janë të pranueshme.

#### 2. Përmbajtja faktike e ankesave të paraqitura nga dhe në emër të të pandehurit K.P.

Ankesat e paraqitura në emër të dhe nga i pandehuri K.P. janë të bazuara mirë.

Në lidhje me dënimin e K.P. për veprën penale të Mashtrimit (neni 261 paragrafi 2 i KPK-së), nuk ka pasur një akuzë të tillë të ngritur nga një prokuror i autorizuar. Gjyqtari konfirmues e kishte shtuar këtë akuzë *ex officio* në Aktvendimin e konfirmimit KA. Nr. 552/2011, të datës 15 shtator 2011 si akuzë shtesë në Aktakuzë. Në bazë të nenit 403 paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPPK-së, kjo paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale.

Pasi që këto akuza nuk janë ngritur nga një prokuror i autorizuar, *mutatis mutandis* me nenin 316 paragrafi 2 të KPPK-së, Gjykata e Apelit iu desh që t'i hidhte poshtë akuzat për Mashtrim (neni 261 paragrafi 2 të KPK-së).

Për shkak të faktit se akuza e Mashtrimit është e ndërlidhur ngushtë me akuzat e tjera, është e pashmangshme se hedhja poshtë e kësaj akuze ndikon në vlerësimin e akuzave të tjera kundër të pandehurit. Prandaj, pjesa dënuese e Aktgjykimit të kundërshtuar u desh të anulohet tërësisht dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

#### a) Akuzat për veprën penale të Mashtrimit

Aktakuza e ngritur nga prokurori në këtë rast nuk përmbante akuzë për Mashtrim në lidhje me ndonjërin nga të pandehurit. Në seancën e konfirmimit, gjyqtari, pas shqyrtimit të të gjitha fakteve të pretenduara nga prokuroria në mbështetje të akuzave të pretenduara në aktakuzë, vendosi që këto fakte (përveç akuzave tashmë të pretenduara në aktakuzë), do të mbështesin gjithashtu akuzën për Mashtrim kundër secilit nga të pandehurit. Gjyqtari konfirmues pastaj shtoi në aktakuzë gjuhën e mëposhtme:

*"6. Akuzë shtesë - Mashtrimi. Përshkrimi faktik i dhënë nga prokurori publik e bën të qartë se të pandehurit i kishin përdorur dokumentet e falsifikuara, të cilat ishin krijuar me anë të shpërdorimit të pozitës zyrtare nga K.P., në mënyrë që të kryenin vepra të tjera të Mashtrimit në dëm të shoqërisë së sigurimit. Në fakt, aktet e falsifikuara ishin përdorur nga ana e tani të ndjerit H.H. për të mashtruar anëtarët*

*e tjerë të komisionit, i cili i jepte kompensimet, kështu duke e mashtruar kompaninë e sigurimeve.*

*Kjo rezulton që, në pajtim me nenin 316 paragrafi 6 i KPPK-së, faktet e përshkruara në aktakuzë duhet të ri-cilësohen, që të përfshijë edhe veprën penale të Mashtrimit në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 i KPK-së. Akuza mund të jepet më poshtë:*

*"Mashtrimi, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 i KPK-së, për shkak se, me kryerjen e veprave penale të përshkruara në pikat 3 dhe 5, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, ata krijuan edhe dokumente false (të përshkruara më mirë në aktakuzë), të cilat më pas janë dorëzuar në kompaninë e sigurimeve "Kosova " në likuidim dhe kështu i kanë mashtruar zyrtarët e të njëjtës kompani të sigurimeve, e cila ishte e ngarkuar për dhënien e kompensimeve, të cilët si pasojë ua paguan të pandehurve shumat e përshkruara më mirë në shpjegimin faktik të përfshirë në faqet 17 dhe në vijim të versionit në gjuhën angleze të aktakuzës."*

*Mbetet e qartë se ky nuk është një fajësim i ri, por thjesht një ri-cilësim i fakteve, të cilat janë të përfshira në mënyrë të qartë në aktakuzën e prokurorit. Prokurori Publik është padyshim i lirë për të ndryshuar dhe për të specifikuar, nëse konsiderohet e nevojshme, këtë akuzë të re të aktakuzës. "*

Siç mund të shihet nga gjuha e cituar më sipër, Gjyqtari i Konfirmimi bëri një vërtetim *ex officio* se faktet e pretenduara në aktakuzë do të mbështesnin një akuzë të Mashtrimit kundër të gjithë të pandehurve; e përpiloi gjuhën për këtë akuzë; dhe e shtoi këtë akuzë në aktakuzë.

Përveç kësaj, pastaj Gjyqtari theksoi qartësinë ligjore, duke thënë se prokurori mund të ndryshojë këtë akuzë të re të aktakuzës që ai e kishte përpiluar, nëse prokurorit do t'i dukej e nevojshme.

Megjithatë, Prokurori nuk e ka "ndryshuar" ose "specifikuar" ndonjë akuzë të re të aktakuzës. Kjo çështje doli në gjyq pas Aktakuzës së ndryshuar nga gjyqtari konfirmues , në lidhje me kundërshtimet e të paktën të të pandehuri K.P. ndaj trupit gjykues. I pandehuri K.P. e ka ngritur këtë çështje përsëri në Ankesën e tij dhe Ankesën e paraqitur nga avokati i tij mbrojtës.

Si justifikim për veprimet e tij të përmendura më sipër, gjyqtari konfirmues citoi nenin 316, nën-paragrafin 6 të KPPK-së për të mbështetur konstatimet e tij që faktet në aktakuzë, *"... duhet të ri- cilësohen, për të përfshirë edhe veprën penale të Mashtrimit ..."* .

Paneli thekson se gjuha në lidhje me "ri-cilësimin" e fakteve nuk duket askund në KPPK. Më veçanërisht, ajo gjuhë nuk paraqitet në nenin 316 nën-paragrafi 6 i KPPK-së. Gjuha në këtë nën-paragraf në lidhje me kompetencat e Gjyqtarit të Konfirmimit është:

*"(6) Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale, siç është parashtruar nga prokurori në aktakuzë"*

Siç mund të shihet më lart, gjuha e këtij nën-seksioni vetëm siguron se gjyqtari konfirmues nuk është i lidhur me "cilësimin juridik" të veprës penale. Gjuha i referohet vetëm ndryshimit të "cilësimit juridik" të një vepre të caktuar të akuzuar në aktakuzë. Pra, kjo gjuhë vetëm lejon gjyqtarin e Konfirmimit për të vlerësuar faktet që lidhen me një akuzë të caktuar dhe për të ndryshuar cilësimin juridik të asaj akuze, nëse ai ose ajo mendon se kjo është e nevojshme. Për shembull, në qoftë se prokuroria kishte dyshuar për kryerjen e një Mashtrimi nga disa persona "në bashkëkryerje", por faktet e pretenduara iu duken Gjyqtarit të Konfirmimit vetëm mbështetje të "ndihmës" në Mashtrim, gjyqtari mund të ndryshojë cilësimin juridik të veprës në aktakuzë për të pasqyruar këtë.

Duhet të theksohet se gjuha e cituar më lart është pothuajse identike me gjuhën në nenin 386 paragrafi 2 të KPPK-së lidhur me autoritetin e kryetarit të trupit gjykues apo kolegjit gjatë nxjerrjes së aktgjykimit në një rast. Aty, gjuha është,

*"(2) Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës."*

Duket qartë se gjuha në nenin 386 paragrafi 2 të KPPK-së lidhur me autoritetin e gjyqtarit synon të shërbejë për të njëjtin qëllim si gjuha në nenin 313, paragrafi 6 i KPPK-së përcaktimin e autoritetit të Gjyqtarit të Konfirmimit – që do të thotë për të lejuar gjykatën që të bëjë cilësimin e duhur të shkëljes së pretenduar, nëse beson se nuk ka qenë i cilësuar siç duhet nga prokurori. Në asnjë rast gjykata nuk lejohet që të shtojë një akuzë shtesë që tashmë nuk është pretenduar nga prokurori.

Neni 6 i KPPK-së përcakton rolin themelor dhe autoritetin e prokurorit. Fjalja hapëse e paragrafit 1 e kësaj dispozite parashikon si më poshtë:

*"Procedura penale fillohet vetëm me kërkesë të paditësit të autorizuar."*

Këtu, ishte gjyqtari konfirmues ai, i cili kërkoi të fillojë procedura penale për akuzën e Mashtrimit. Ai në mënyrë të qartë nuk kishte autoritet për ta bërë këtë dhe vet prokurori nuk e ka filluar akuzën e Mashtrimit.

Neni 402, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 i KPPK-së parashikon që ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë kur,

*"ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale."*

Neni 403, paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPPK-së parashikon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nëse,

*“gjkata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e paditësit të autorizuar...”*

Më tej, neni 403 paragrafi 2 i KPPK-së parashikon se,

*“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjykata gjatë kohës së përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë procedurën paraprake ... nëse.*

*(1) Nuk është zbatuar ndonjë dispozitë e këtij Kodi ose është zbatuar gabimisht*

*...*

*dhe kjo ka ndikuar ose ka mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.”*

Këtu, gjyqtari konfirmues qartazi e ka zbatuar gabimisht nenin 316 paragrafi 6 të KPPK-së duke shtuar një akuzë të re të mashtrimit në aktakuzë pa autoritetin për ta bërë këtë. Trupi gjykues pastaj bëri shkelje esenciale të dispozitës së nenit 403 paragrafi 1, nën-paragrafi 5 të KPPK-së duke mos e rrëzuar akuzën e mashtrimit që nuk ishte ngritur nga prokurori i autorizuar.

#### **b) Akuzat e mbetura**

Gabimi i gjyqtarit konfirmues futi në këtë lëndë një akuzë penale të pavlefshme kundër të gjithë të pandehurve, të cilën trupi gjykues e gjykoi gabimisht dhe për të cilën i pandehuri K.P. u gjet fajtor dhe u dënua me burgim. Aktgjykimi në këtë lëndë për pjesën që lidhet me akuzën e mashtrimit, është i paligjshëm dhe i parregullt. Për shkak se kjo akuzë ishte kaq ngushtë e ndërlidhur me akuzat e tjera në këtë lëndë, thjesht prapësimi i dënimit të të pandehurit K.P. në lidhje me këtë akuzë nuk është mjet i mjaftueshëm. Është e pamundur të vërtetohet ndikimi që prania dhe gjykimi i kësaj akuze pati në vendimet e përgjithshme për fajësinë apo pafajësinë për akuzat e tjera, si dhe ndonjë ndikim që mund të ketë pasur në masën e dënimit. Prandaj, trupi gjykues nuk e pati mundësinë e thjesht modifikimit të aktgjykimit të kundërshtuar. Nuk kishte asnjë alternativë tjetër përveç asaj të anulimit të të gjithë lëndës kundër K.P. dhe kthimit të saj përsëri në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

### **3. Meritat e ankesës së ushtruar nga Prokurori Special**

**a) Akuza e shmangies nga tatimi kundër të pandehurit K.P.**

Ankesa e paraqitur nga Prokurori Special kundër Aktgjykimit të kontestuar është pjesërisht e bazuar në lidhje me pjesën që e liron të pandehurin K.P.A nga akuza. Kjo pjesë e Aktgjykimit anulohet dhe kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Pjesa e mbetur e Ankesës refuzohet si e pabazuar.

Secili nga të pandehurit u akuzua në Aktakuzë për shmangie nga tatimi pasi nuk raportuan dhe nuk paguan tatimin mbi shumat e ndryshme që secili i pandehur pretendohet të ketë nxjerrë nga skema kriminale siç pretendohet nga prokurori. Të pandehurit L. P. dhe Z. M. u liruan nga kjo akuzë nga trupi gjykues në bazë të nenit 390 nën-paragrafi 3) pas konstatimit nga ana e trupit gjykues se prokuroria kishte dështuar ta provonte këtë akuzë. Trupi gjykues mbajti një pozicion shumë të ndryshëm lidhur me të pandehurin K.P. kur vendosi për këtë akuzë.

Në dispozitivin e aktgjykimit në lidhje me të pandehurin K.P., trupi gjykues e liroi atë nga këtë akuzë, duke deklaruar,

*“Sepse, në bazë të nenit 390, paragrafi 2, të KPPK-së, ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale në lidhje me dështimin e të pandehurit për të dhënë informacion për të ardhurat e tij të paligjshme nga mashtrimi i Kompaninë Kosovare të Sigurimit.”*

Më vonë në Aktgjykimin, në pjesën me titullin, PËRGJEGJËSIA PENALE E TË PANDEHURVE, në faqen 65 të versionit në gjuhën angleze të Aktgjykimit, trupi gjykues, në mënyrë krejtësisht neutrale parashtron pretendimet e Aktakuzës lidhur me shmangien nga tatimi dhe qëndrimin e të pandehurit K.P. në lidhje me këto pretendime, përfshirë deklarinimin,

*“Ai (K.P.) nuk e mohon se nuk i raportoi tarifat dhe shpenzimet që mori në ato raste që ai pretendon se ishin të H. H..”*

Pasi dështoi plotësisht të analizonte provat në lidhje me këtë akuzë dhe me gjithë pranimin nga ana e të pandehurit K.P. se ai nuk i raportoi tarifat dhe shpenzimet e tij në disa çështje, gjykata vazhdoi duke thënë:

*“... (T)rupi gjykues ka vendosur që t'i kërkoje K. P. të zbulonte fitimet e tij të siguruara në rrugë joligjore për qëllime tatimore, apo edhe tarifat dhe shpenzimet e*

*tij, do të shkelte të drejtën e tij themelore kundër vetë-inkriminimit, dhe për këtë arsye e ka gjetur atë jo fajtor për këtë vepër.”*

Trupi gjykues nuk dha asnjë analizë apo vlerësimi ligjor për ta mbështetur këtë konstatim ligjor.

Prokuroria në Ankesën e saj për këtë akuzë vetëm argumenton në lidhje me mjaftueshmërinë e provave për të mbështetur akuzën dhe injoron tërësisht çështjen ligjore që është në thelb të vendimit të trupit gjykues.

Gjetja e trupit gjykues se t'i kërkoje raportimin nga i pandehuri K.P. të *“fitimeve të tij të siguruara në rrugë joligjore”* do të *“shkelte të drejtën e tij themelore kundër vetë-inkriminimit”*, ngre tri pyetje themelore ligjore:

- 1.) A ishin të tatueshme sipas ligjit në fuqi në Kosovë *“fitimet e tij të siguruara në rrugë joligjore”*;
- 2.) Në kohët përkatëse në lidhje me raportimin e të ardhurave, a njihte Kosova një *“të drejtë themelore kundër vetë-inkriminimit”* të përgjithshme; dhe
- 3.) Nëse Kosova vërtet e njihte një të drejtë të tillë, a do të shkelte raportimi i kërkuar këtyre të ardhurave në formën e taksave të drejtën themelore të të pandehurit K.P. kundër vetë-inkriminimit?

Gjykata e Apelit përfundon se përgjigja e pyetjes 1.) është: *“Po”*; e Pyetjes 2.) *“Jo”*, dhe se rrjedhimisht, 3.) detyrimi ligjor i të pandehurit për të raportuar të gjitha të ardhurat e tij nuk shkelte asnjë nga të drejtat e tij.

Aktakuza në këtë rast përfshin periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2010. Gjatë asaj periudhe në Kosovë ka pasur tre regjime të ndryshme tatimore në fuqi në kohë të ndryshme.

#### aa) Fitimet e paligjshme si të ardhura të tatueshme

Në vitin 2000 UNMIK shpalli Rregulloren 2000/29, që vendosi taksën e parë mbi të ardhurat në Kosovë pas konfliktit. Ky ligj tatonte vetëm rrogëtarët. Në vitin 2002 UNMIK-u shpalli Rregulloren 2002/4, e cila vendosi një tarifë paushall të sheshtë sipas kategorisë së punës si një tatim mbi të ardhurat nga burime të tjera krahas rrogës. Në vitin 2004 UNMIK-u shpalli Rregulloren 2004/52, ligji i parë që kërkon raportimin e të ardhurave faktike jo vetëm nga ana e rrogëtarëve, dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat bazuar në



shumën e të ardhurave të raportuara. Kjo rregullore hyri në fuqi më 1 janar 2005. UNMIK-u pastaj miratoi Udhëzimin Administrativ 02/2005 për zbatimin e Rregullores 2004/52. Në vitin 2008 Qeveria e Kosovës miratoi legjislacionin e vet për tatimin mbi të ardhurat personale, që gjendet në Ligjin Nr. 03/L-115. Ai hyri në fuqi nga 1 janari 2009. Ky ligj u ndryshua më vonë me Ligjin e Kosovës, Nr. 03/L-161, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2010.

Në vitin tatimor 2005 për herë të parë pas konfliktit u fut detyrimi për të raportuar të ardhurat faktike edhe për të tjerët, krahas rrogëtarëve. Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/52 i përkufizonte “të ardhurat e tatueshme”, si më poshtë:

*“Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës së tatimit dhe zbritjet e lejueshme sipas kësaj Rregulloreje lidhur me të ardhurat e tilla bruto.”*

“Të ardhurat bruto” përcaktohen më pas në Nenin 6. Pas një liste të gjatë të llojeve të veçanta të të ardhurave, ai përfshin klauzolën e përkufizimit të përgjithshëm:

*“J. Të gjitha të ardhurat e tjera që e rrisin vlerën neto të tatimpaguesit.”*

”Të ardhura të tjera” përkufizohet në nenin 15 të Rregullores si vijon:

*“Të ardhurat bruto përfshijnë çdo formë tjetër të të ardhurave nga çfarëdo burimi, siç janë të ardhurat nga lotaria ose nga fitimet në lojërat e fatit, apo të ardhurat nga faljet e borxheve.”*

Në Udhëzimin Administrativ 02/2005 në Seksionin 16 “të ardhura të tjera” është përkufizuar sërish si vijon:

*“Të ardhura të tjera” siç ceken në nenin 15 të Rregullores përfshijnë çdo të ardhur tjetër të cituar në mënyrë specifike në nenin 6 të Rregullores dhe që përfshijnë çmimet e lotarive jo-para, p.sh. makina, falja e borxhit, etj., të cilat rrisin vlerën neto të tatim-paguesit.”*

Së fundi, Neni 27 i Udhëzimit Administrativ 02/2005 përcakton formën që do të përdoret nga taksapaguesit për të raportuar të ardhurat personale. Në rreshtin 19 nën titullin të

“Ardhurat Bruto” ka një vend ku raportohen “Të ardhurat e tjera” me udhëzimin “Specifiko”.

Duke pasur parasysh përkufizimin e gjerë të termit “të ardhura të tjera” të përfshirë në rregulloret e UNMIK-ut, dhe faktin se nuk në rregulloret nuk ka asgjë që i përjashton të ardhurat e paligjshme nga tatimi, është e logjikshme të konkludohet se sipas rregulloreve të UNMIK-ut, të ardhurat e paligjshme kërkohet të raportoheshin si të ardhura të tatueshme.

Në Ligjin e Kosovës Nr. 03/L-115, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2009, mund të shihet një model shumë i ngjashëm në lidhje me përkufizimin e asaj që është e ardhur e tatueshme. Neni 4 i ligjit parashikon përkufizimin e të Ardhurave të Tatueshme:

*“Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës së tatimit dhe zbritjet e lejueshme sipas këtij ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto.”*

Neni 6 pastaj përkufizon “Të Ardhurat Bruto” si më poshtë:

*“1. ... të ardhurat bruto do të thotë të gjitha të ardhurat që pranohen ose shtohen nga të gjitha burimet, duke i përfshirë:*

*...*

*1.10. të gjitha të ardhurat e tjera që e rrisin vlerën neto të tatimpaguesit.”*

Neni 15 pak a shumë parashtron sërish dispozitat e nenit 6 nga sërish deklaruar si më poshtë në lidhje me “të ardhura të tjera”:

*“Të ardhurat bruto përfshijnë çdo formë tjetër të të ardhurave nga çfarëdo burimi ...”*

Sipas këtij ligji nuk ka asnjë përjashtimi nga tatimi as për të ardhurat e paligjshme.

Së fundi, në Ligjin e Kosovës Nr. 03/L-161, në fuqi nga 1 janari 2010, “Të ardhurat e tatueshme” përkufizohen si më poshtë:

*“Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi*

*ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij Ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto.”*

Pastaj të ardhurat bruto përkufizohen si vijon:

*“Përveç për të ardhurat që janë të liruara sipas këtij ligji, të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat që janë pranuar vërtet apo në mënyrë konstruktive nga burimet vijuese:*

...

*2.3. Çdo e ardhur tjetër që është e përfshirë me një akt nënligjor të lëshuar nga ministri.”*

Edhe një herë, nuk ka asnjë përjashtimi nga taksat për të ardhurat e paligjshme në ligj.

Nga gjithçka sa u elaborua më sipër, është e qartë se për të gjithë periudhën kohore përkatëse, në bazë të dispozitave të të gjitha ligjeve tatimore që vendosin detyrimin e raportimit të të ardhurave personale në Kosovë, kërkohet që të gjitha të ardhurat nga çfarëdo burimi – i rregullt apo jo – duhej të raportoheshin dhe ishin objekt i tatimit.

#### ab) Ekzistenca e së drejtës themelore kundër vetë-inkriminimit në Kosovë

Trupi gjykues konstaton se i pandehuri K.P. u akuzua për shmangie nga tatimi, të bazuar në një pretendim se gjatë disa viteve siguroi të ardhura që nuk i raportoi qëllimisht për efekt tatimi. Akuza nuk ka të bëjë me natyrën e aktiviteteve që mund të kenë gjeneruar këto të ardhura. Akuza të tjera për të cilat ai ishte shpallur fajtor i kanë trajtuar këto aktivitete. Kjo është një akuzë në lidhje me zbatimin e ligjeve tatimore dhe dënimin për shkeljen e tyre.

Në qoftë se i pandehuri K.P. do ta kishte raportuar shumën dhe burimin e të ardhurave të dyshuara, ajo që do të kishte ndodhur më pas është një çështje spekulimi të pastër. A do t'i ishte dhënë ky informacion policisë? A do të kishte hetuar policia? A do t'i kishin zbuluar ata aktivitetet që ishin burim i të ardhurave? A do të ishte akuzuar ai për veprat penale që dalin nga këto aktivitete? Dhe, më e rëndësishmja, a mund të ishin përdorur raportimet e tij për detyrimet tatimore të tij si deklarata kundër tij në shqyrtim gjyqësor? Për këto pyetje nuk ka përgjigje sepse K.P. nuk raportoi asnjëherë.

Pyetja që ka ngritur trupi gjykues me aktvendimin e tij është: Çfarë, të drejte kundër vetë-

inkriminimit kishte, nëse kishte, i pandehuri K.P. sipas ligjit penal të Kosovës, që të refuzonte t'u përgjigjej me vërtetësi pyetjeve thjesht administrative në lidhje me të ardhurat e tij në një formë të përdorur në procesin e mbledhjes së tatimeve? A mundet një e drejtë e tillë të bazohet mbi spekulimin e pastër se çfarëdo përgjigjesh që ai mund të kanë dhënë mundej, në një kohë në të ardhmen, të përdorej në një shqyrtim gjyqësor për ta implikuar atë në ndonjë aktivitet kriminal ato kohe të panjohur?

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, e shpallur më 15 maj 2001, me titull, "PËR KORNIZËN KUSHTETUESE TË VETËQEVERISJES SË PËRKOHSHME NË KOSOVË" është pika e fillimit për këtë hetim. Kjo Rregullore nuk përmend shprehimisht ndonjë të drejtë kundër vetë-inkriminimit. Megjithatë, nenet 3.2 dhe 3.3 përcaktojnë në pjesën përkatëse:

*"3.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:*

*(a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;*

*(b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;*

*(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;"*

*"3.3 Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornizë Kushtetuese."*

Siç u theksua më sipër, gjatë periudhës që Rregullorja 2001/9 e UNMIK-ut aplikohet në Kosovë nga 15 maji 2001 deri më 15 qershor 2008, nuk kishte asnjë njohje të drejtpërdrejtë të një të drejte themelore kundër vetë-inkriminimit. Duke pasur parasysh këtë, është e nevojshme të analizohen marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për të përcaktuar nëse njihej një e drejtë e tillë, që do të zbatohet në Kosovë.

**Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** nuk siguron ndonjë bazë për njohjen e një të drejte të tillë. Në asnjërin prej tridhjetë neneve të saj nuk ka asnjë tregues të qartë apo të nënkuptuar të së drejtës kundër vetë-inkriminimit. Kështu që kjo marrëveshje nuk ofron mbështetje për gjetjen e trupit gjykues.

**Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)** dhe Protokollet e saj nuk artikulojnë një të drejtë të tillë kundër vetë-inkriminimit në dokumentet e Konventës. Megjithatë, në vitin 1993 Gjykata Evropiane e të

Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e përfshiu një të drejtë të tillë në nenin 6 të Konventës në rastin e Funk kundër Francës (256 GJEDNJ [ser. A] 1993). Pas kësaj, në një numër rastesh parametrat e kësaj të drejte u përvijuan në rrethana të ndryshme ligjore.

Në vitin 2000, Gjykata e Strasburgut, në lëndën IJL, GMR dhe AKP kundër Mbretërisë së Bashkuar (2000-IX GJEDNJ 323) hodhi poshtë pretendimin se,

*“... një detyrim ligjor që një individ të japë informacionin e kërkuar nga një organ administrativ domosdoshmërisht shkel nenin 6 të Konventës”.*

Në vitin 2003, GJEDNJ vendosi në lëndën Mbreti kundër Mbretërisë së Bashkuar (37 GJEDNJ Rep. 1, 2003). Kjo lëndë është vendimtare për diskutimin e zbatimit të së drejtës kundër vetë-inkriminimit në bazë të Konventës Evropiane për sa i përket të pandehurit K.P. në këtë lëndë.

Në lëndën e Mbretit, i pandehuri po hetohej për pagesë më të ulët të tatimeve. Si pjesë e hetimit ai ishte i detyruar nga autoritetet tatimore t’u përgjigjur pyetjeve në lidhje me të ardhurat, përgjigjet e të cilave çonin në caktimin e një dënimi për nën-raportim. I pandehuri bëri ankesë në GJEDNJ duke pretenduar se përgjigjet e tij të detyruara shkelnin të drejtën e tij kundër vetë-inkriminimit. Gjykata e hodhi poshtë këtë pretendim.

Në refuzimin e padisë së Mbretit, GJEDNJ përcaktoi tri gjetje të rëndësishme. Së pari, gjykata gjeti se Mbreti po dënohej për një detyrim jo të plotë tatimor dhe jo për ndonjë aktivitet të mundshëm kriminal që mund ta kishte paraprirë këtë nën-raportim. Së dyti, Mbreti nuk po ndiqej penalisht për mosdhënien e informacionit që mund ta kishte inkriminuar atë në një vepër penale, por më tepër për mosraportim nga ana e tij. Së fundi, gjykata vendosi se “Privilegji kundër vetë-inkriminimit nuk mund të interpretohet se jep imunitet të përgjithshëm për veprime të motivuar nga dëshira për të shmangur hetimin e autoriteteve të të ardhurave.” Ky konstatim në këtë lëndë nuk është kufizuar, as rrëzuar.

KEDNJ dhe Protokollet e saj nuk ofrojnë bazë për pohim nga trupi gjykues se të kërkuarit që i pandehuri K.P. të raportonte fitimet e tij në rrugë jo të ligjshme do të kishte shkelur të drejtën e tij themelore njerëzore kundër vetë-inkriminimit.

**Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** dhe Protokollet e saj në Nenin 14 Pjesa 3 parashikon:

*“Në përcaktimin e ndonjë akuze penale kundër tij, gjithkush ka të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, në barazi të plotë:*

...  
(g) *Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë* “.

Nga gjuha e këtij Neni mund të shihet se e drejta kundër vetë-inkriminimit lind vetëm në lidhje me “... *përcaktimin e ndonjë akuze penale* ...” Një përmbledhje e jurisprudencës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, trupi i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, nuk zbulon asnjë shembull ku një e drejtë e tillë është zgjeruar për të mbështetur të drejtën e një personi për të refuzuar të japë informacionin e kërkuar në lidhje me të ardhurat në procesin e mbledhjes së taksave. Në qoftë se një informacion i tillë mund të thuhet se është vetë-inkriminues, atëherë, nëse dhe kur nisin disa procedura penale, mund të jetë që kjo provë nuk mund të përdoret në shqyrtim gjyqësor. Megjithatë, ky lloj spekulimi ka asnjë përkatësi për procedurat e tanishme penale kundër të pandehurit K.P., sepse, siç u theksua më sipër, i pandehuri K.P. nuk dha përgjigje të tilla në formularin e tij tatimor; ai nuk raportoi fare.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj nuk ofrojnë bazë për pohim nga ana e trupit gjykues që kërkesa që i pandehurin K.P. të raportojë fitimet e tij në rrugë jo të ligjshme do të kishte shkelur të drejtën e tij themelore njerëzore kundër vetë-inkriminimit.

**Kushtetuta e Kosovës**, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008, nuk e përmend fare drejtpërdrejtë të drejtën kundër vetë-inkriminimit ose, me përjashtim të nenit 30 paragrafi 6, që thotë se kushdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë, “... *të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë e tij.*” Meqë në kohën kur Aktakuza pretendon se ai nuk i raportoi të ardhurat e tij të tatueshme, i pandehuri K.P. nuk ishte akuzuar me ndonjë veprë penale kjo dispozitë në mënyrë të qartë nuk zbatohet.

Ashtu si Rregullorja e UNMIK-ut, që e parapriu atë, Kushtetuta e Kosovës nuk bën fjalë për të drejtave themelore të njeriut dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare. Kjo referencë gjendet në Nenin 22 dhe përcakton në pjesën përkatëse:

*“Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]*

*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

*(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*

*(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*

*(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj;”*

Ndërsa Neni 22 duket se miraton pa mëdyshje marrëveshjet ndërkombëtare të listuara atje dhe në fakt u jep atyre përparësi mbi ligjet e miratuara në Kosovë, ekziston një kufizim i dukshëm – dhe i madh – në zbatimin e këtyre marrëveshjeve, që gjendet në nenin 55 të Kushtetutës. Ai përcakton në pjesën përkatëse:

*“Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]*

*1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

*2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*

*3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*

*4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*

*5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.”*

Neni 2 lejon kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë “në masën e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kufizimit në një shoqëri të hapur dhe demokratike.”

Përveç kësaj, Neni 4 përcakton një grup të veçantë kriteresh që duhet të merren parasysh nga “... të gjitha autoritetet publike, dhe në veçanti gjykatat ...” (theksimi i shtuar) kur

merren me “... kufizimin e të drejtave të njeriut ose interpretimin e këtyre kufizimeve ...” të mundshme.

Duke krahasuar Rregulloren 2001/9 të UNMIK-ut me Kushtetutën e tanishme të Kosovës, është e qartë se ajo që ishte, sipas Rregulloreve të UNMIK-ut, në thelb zbatim i pakufizuar dhe mbizotërues i të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, është ndryshuar nga Kushtetuta në mënyrë të tillë që të drejtat themelore të njeriut, përfshirë edhe ato të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, mund të kufizohen nëpërmjet një procesi të kujdesshëm analitik bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 55 paragrafi 4.

Megjithatë, pasi që Kushtetuta e Kosovës miraton të njëjtat marrëveshje ndërkombëtare përkatëse si Rregullorja 2001/9 e mëhershme e UNMIK-ut, analiza e mësipërme nuk ka nevojë të përsëritet. Përfundimi është i njëjtë. Në fakt, dispozita në Kushtetutën e Kosovës që lejon kufizimin e mundshëm të të drejtave të njeriut në rrethana të caktuara në fakt e dobëson më tej rastin e një të drejte themelore kundër vetë-inkriminimit sipas fakteve relevante për të pandehurin K.P..

#### ac) Përfundim

Rrjedhimisht, trupi gjykues vjen në përfundimin e lartpërmendur se gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë Aktakuzë nuk ishte në fuqi ndonjë e drejtë themelore e njeriut kundër vetë-inkriminimit, që nuk do të ndikonte në detyrimin ligjor të të pandehurit K.P. për të raportuar plotësisht dhe me saktësi shumë dhe burimin e të gjitha të ardhurave të tij – të ligjshme ose të paligjshme – në raportin e tij tatimit për të ardhurat në Kosovë.

#### **b) Akuza e krimit të organizuar**

Trupi gjykues hedh poshtë argumentet e ngritura në Ankesën e Prokurorit Special në lidhje me akuzën penale kundër të pandehurit K.P. për veprën penale të krimit të organizuar. Vepra penale kërkon ekzistencën e “një grupi të organizuar kriminal”. Neni 274 paragrafi 7 nën-paragrafi 2 i KPK-së e përkufizon këtë term si vijon:

*“...grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim...”*

Nën-paragrafi 4 i së njëjtës dispozite e përcakton “grupin e strukturuar” kështu:

*“...grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale...”*



Në rastin e tanishëm, meqë të pandehurit Z.M. dhe L.M. u shpallën jo fajtorë për kryerjen e veprës penale në fjalë dhe – siç do të arsyetohet më poshtë – trupi gjykues nuk gjen arsye për të përmbysur gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në këtë drejtim, mund të kenë qenë maksimum vetëm dy persona pjesëmarrës në një grup të organizuar kriminal: i pandehuri K.P. dhe i ndjeri H.H.. Ky numër nuk e plotëson kërkesën e nenit 274 paragrafi 1 të KPK-së.

#### **c) Akuzat e mbetura kundër të pandehurit K.P.A**

Gjykata konstaton se akuzat e mbetura kundër të pandehurit janë të ndërthurura ngushtë me akuzën e mashtrimit që u desh të rrëzohej. Ato nuk mund të vlerësohen veçmas nga Gjykata e Apelit, pa një vlerësim të ri të të gjitha provave në tërësinë e tyre. Prandaj, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, pjesa e Aktgjykimit të kundërshtuar në lidhje me lirimin e të pandehurit K.P. nga këto akuza u desh të anulohet dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

#### **d) Akuzat kundër të pandehurve Z.M. dhe L.M.**

Trupi gjykues i gjen pa bazë kundërshtimet në Ankesën e Prokurorit Special kundër lirimeve nga akuzat të të pandehurve Z. M. dhe L. P.

Ankesa e Prokurorisë në lidhje me secilin prej këtyre të pandehurve thjesht bazohet në një mospajtim me gjetjet faktike nga trupi gjykues.

Të dy të pandehurit pretendohej në Aktakuzë se e kanë ndihmuar të pandehurin K.P. në falsifikimin e kërkesave të ndryshme për kompensim për një numër njerëzish. Trupi gjykues gjeti se prova e vetme e përfshirjes së drejtpërdrejtë të të pandehurit Z. M. ishte se ai kishte hapur një llogari bankare për të cilën K.P. ishte përdorues i autorizuar. Trupi gjykues në fakt gjeti se nënshkrimet e supozuara të të pandehurit Z. M. në dokumente të ndryshme ishin të gjitha falsifikime. Nga një lexim i mendimit të trupit gjykues është e qartë se ai bëri një analizë të kujdesshme të provave me një qëndrim veçanërisht skeptik, por gjeti se provat objektive thjesht nuk mbështetnin gjetjen e pjesëmarrjes së tij në ndonjë aktivitet kriminal.

Në lidhje me të pandehurin L. P. situata është shumë e njëjtë. Në shqyrtimin e pjesëmarrjes së tij në këtë çështje, trupi gjykues e gjeti përsëri sjelljen e tij shumë të dyshuar, por nuk mundi ta provojë përtej dyshimit të arsyeshëm përfshirjen e tij në ndonjë nga veprimtaritë kriminale të pretenduara. Trupi gjykues gjeti se i pandehuri L. P. u mashtrua nga i

pandehuri K.P. në një rast ku ai në të vërtetë mori pjesë. Ai gjithashtu gjeti se ndërsa ai me siguri duhet të ketë ditur se i pandehuri K.P. nuk ishte në rregull në një transaksion pronësor që i pandehuri L. P. kreu për të, nuk pati prova se ai e dinte se fondet për transaksionin e kishin origjinën nga aktivitetet kriminale të K. P.

Gjykata e Apelit e Kosovës ka zbatuar shpesh parimin e përgjithshëm se është e nevojshme t'i jepet një shkallë e konsiderueshme pranimi të gjetjeve faktike të trupit gjykues pasi ky i fundit ka dëgjuar provat dhe është në pozitë më të mirë për të vlerësuar peshën dhe vlerën e tyre<sup>3</sup>. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur qëndrimin se duhet,

*“... të pranojë vlerësimin nga ana e Trupit Gjykues të besueshmërisë së dëshmitarëve të shqyrtimit gjykues të cilët u paraqitën personalisht para tyre dhe të cilët dëshmuuan personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme që Gjykata Supreme e Kosovës të dalë mbi vlerësimin e Trupit Gjykues të besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka bazë të shëndoshë për ta bërë këtë.”*

Gjykata vazhdoi të thotë se standardi që do të zbatohet është:

*“... të mos të trazohen gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur gjykata nuk mund të ishin pranuar nga një gjykatë e arsyeshme fakti, ose kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar.”<sup>4</sup>*

Duke zbatuar parimet e përgjithshme të mësipërme, kjo Gjykatë nuk gjen baza mbi të cilat të trazojë gjetjet, arsyetimin ose vendimet e trupit gjykues në lidhje me të pandehurit Z. M. dhe L. P.

Bazuar në argumentet e lartpërmendura dhe në përputhje me nenet 420 paragrafi 1, nënparagrafët 2 dhe 3, 423 dhe 424 paragrafët 1 dhe 5 të KPP-së, Gjykata e Apelit vendos si në dispozitiv.

*Origjinali i hartuar në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar.*

### **Anëtarë të trupit gjykues:**

<sup>3</sup> Shih për shembull, Gjykata e Apelit e Kosovës PAKR 1121/12, 25 shtator 2013, paragrafi 48.

<sup>4</sup> Gjykata Supreme e Kosovës APi.-KZi. 84/2009, datë 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, APi.-KZi. 2/2012, datë 24 shtator 2012, paragrafi 30.

---

**Fllanza Kadiu**  
Gjyqtare e Gjykatës së Apelit

---

**Fillim Skoro**  
Gjyqtare e Gjykatës së Apelit

**Kryetar i trupit gjykues:**

---

**Piotr Bojarczuk**  
Gjyqtar i EULEX-it

**Proces-mbajtës:**

---

**Holger Engelmann**  
Oficer ligjor i EULEX-it

**GJYKATA E APELIT**  
**PAKR. Nr. 45/2013**  
**Prishtinë**  
**31 korrik 2015**